



|  |      |                          |            |
|--|------|--------------------------|------------|
| ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS<br>KOSOVO DOCTORS CHAMBER<br>LEKARSKA KOMORA KOSOVA |      |                          |            |
| Njëzia:<br>Unit:   | Kçe  | Nr. Prot.:<br>Prot. No.: | 04/2018    |
| Jednica:<br>Jedn.:   |      | Br. Prot.:<br>Br. Prot.: |            |
| Nr. i faqeve:<br>No. of pages:   | -01- | Data:<br>Datum:          | 03.08.2018 |
| Br. stranca:<br>Br. stranica:  |      | Prishtinë/a              |            |

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## KOMISIONI PËR ÇËSHTJE ETIKE

NR. REF: 04/2018

DATË:

|    |    |      |
|----|----|------|
| 03 | 08 | 2018 |
|----|----|------|

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE ETIKE, në mbështetje të Nenit 9, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.6, Nenit 35, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 dhe Nenit 36 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 47, paragrafin 1 me nënparagrafin 1.1 dhe Nenin 49 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 4, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 të Rregullores për Fushëveprimin dhe Kompetencat e Komisionit për Çështje Etike, Komisioni për Çështje Etike me datë 03 gusht 2018, lëshon këtë:

## LEJIM PËR HULUMTIM BIO-MJEKËSOR

Në bazë të kërkesës së **Accesible Quality Healthcare (AQH)**, me seli në adresë Rr. Tirana, C 4/3 Hyrja D, Kati VI, nr. 16, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga **Qamile Ramadani, zv/udhëheqëse e Projektit "Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (KSHQDC -AQH)"**, në bazë të dokumentacionit të parashtruar pranë Komisionit për Çështje Etike të OMK-së, duke u mbështetur në zbatimin e përkohshëm të dispozitave të Nenit 10 të Udhëzimit Administrativ 05/2012 për Mbikëqyrje Etike Profesionale, Komisioni vlerëson se:

Aplikuesit **Accesible Quality Healthcare (AQH)**, i lejohet implementimi i hulumtimi në kuadër të Projektit "**Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (KSHQDC -AQH)**" për periudhën kohore gusht – dhjetor 2018 për zbatim të hulumtimit në të gjitha Institutet Shëndetësore të Kujdesit Parësor në të gjitha komunitat e Republikës së Kosovës.

Me këtë akt të lejimit vërtetohet se aplikuesi ka përmbushur kriteret e vlerësuara nga Komisioni për Çështje Etike për të kryer hulumtimin e lejuar sipas kërkesës së parashtruar nga aplikuesi.

Subjekti që implementon hulumtimin e lejuar sipas këtij akti të lejimit, është i obliguar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të hulumtimit të dorëzojë raportin në formë të shkruar lidhur me hulumtimin e zbatuar sipas lejimit pranë Komisionit për Çështje Etike.

| Vendi     | Data       | Kryetari i Komisionit për Çështje Etikel |
|-----------|------------|--|
| Prishtinë | 03.08.2018 | Prof.Dr. Fehmi Ahmeti                    |



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij akti, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita pranimit të tij. Ankesa duhet parashtruar pranë Këshillit Drejtues të OMK-së.